



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të dispozitave të nenit 22 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të nenit 19 dhe 40, par.3, shkronja III të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.08.2006, merr

V E N D I M
P Ë R
RITHEMELIMIN E MUZEUT DHE INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË
KOMUNËS SË PRISHTINËS

Neni 1

Rithemelohet Muzeu dhe Instituti i Monumenteve të Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: Muzeu dhe Instituti).

Neni 2

Qëllimi i rithemelimit të Muzeut dhe Institutit, nga neni 1 i këtij Vendimi, është rregullimi dhe udhëheqja më e lehtë e çështjeve të monumenteve dhe Muzeut për Komunën e Prishtinës.

Fushëveprimi dhe përgjegjësitë e deleguara nga Komuna në Muze dhe Institutin e Monumenteve, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohen me Statutin dhe aktet tjera normative të këtij Instituti.

Neni 3

Muzeu dhe Instituti do të përgatisin Statutin dhe aktet tjera normative për punën dhe organizimin e tij.

Statuti dhe aktet tjera normative, nga par.1 i këtij neni, do të miratohen nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Komuna kontrollon dhe mbikëqyr afarizmin financiar të Muzeut dhe Institutit, të themeluar sipas këtij Vendimi.

Për shërbimet publike të kryera nga Muzeu dhe Instituti, i themeluar sipas këtij Vendimi, Kuvendit të Komunës duhet t'i dorëzohet buxheti për miratim në fillim të muajt dhjetor, para çdo viti vijues fiskal.

Buxheti i propozuar, nga par. 2 i këtij neni, duhet të përfshijë llojin dhe lartësinë e tarifës së propozuar për kryerjen e shërbimeve.

Neni 5

E drejta e shfrytëzimit të paluajtshmërisë, e regjistruar në emër të ish-Entit për Mbrojtjen dhe Prezentimin e të Mirave Kulturore të Komunës së Prishtinës para miratimit të këtij Vendimi, do të kthehet në të drejtë të shfrytëzimit nga Komuna e Prishtinës.

Bazë për ndryshimet e së drejtës, nga par.1 i këtij neni, në evidencat kadastrale, do të jetë ky Vendim.

Neni 6

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryeshefi i Ekzekutivit përmes Bordit të drejtorëve të Komunës së Prishtinës.

Neni 7

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen të gjitha vendimet dhe aktet tjera të nxjerra nga ish-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ose organet tjera me të cilat është themeluar Enti, apo aktet e regjistrimit të bëra para marrjes së këtij Vendimi.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.631-436, më 31.08.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri